



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCES DHE INOVACIONIT MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKA I TEHNOLOGJI MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVES-SEKTOR ARCHIVE ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	5
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	3912
Data Datum	24.12.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo obrazovanja,
nauke, tehnologije i inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

DATË/A:	24.12.2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kolegji i Menaxhmentit Internacional "GLOBUS"
CC:	Fadile Dyla – Sekretare e përgjithshme MASH TI
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Burim Gashi – u.d Drejtor në DALSH TI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Dorëzimi i Librave Amë të të diplomuarve të Kolegjit Globus

I nderuar z. Arifi Sekretar Gjeneral i Kolegjit Globus,

Kemi shqyrtuar kërkesën tuaj me nr. të prot. 3912 të dt. 17.12.2024, si dhe duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi dhe duke u mbështetur në Ligjin mbi Arsimin e Lartë, Ligjin e Arkivave të Kosovës kemi ardhur në përfundim që të aprovohet kërkesa për dorëzimin e librave amë të të diplomuarve në dy kopje, njëra kopje t'i dorëzohet DALSH TI dhe njëra kopje Qendrës "NARIC".

Me respekt,

Nga: Kolegji i Menaxhmentit Internacional "Globus"

Për: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)

E nderuar Znj. Fadile DYLA, Sekretare e Përgjithshme

I nderuar Z. Burim GASHI, Drejtor i Arsimit të Lartë

I nderuar Z. Habib ALIU, Zyrtar i Lartë për Arsimit të Lartë Privat

2	ku Proq: Drej. Proq: Prest. No: Data: Datum: 17.12.24
---	---

Lënda: Kërkesë për dorëzimin e librave amë të të diplomuarve të Kolegjit Globus

Të nderuar,

Kolegji i Menaxhmentit Internacional "Globus" aktualisht është në proces të likuidimit si institucion arsimor. Arhivën dhe gjithë dokumentacionin e Kolegjit Globus e kemi në kampusin në Podujevë. Kolegji Globus është themeluar në vitin 2007 dhe deri në vitin 2019 kemi punuar me akreditim institucional, akreditim të programeve dhe licenca nga MASHTI. Pastaj kemi dështuar dy herë për ri-akreditim të programeve dhe ri-akreditim institucional për kampusin në Prishtinë dhe dega në Podujevë, në muajin qershor 2022 e kemi pranuar vendimin e AKA-së për mos akreditim institucional për herë të dytë dhe pas konsumimit të të gjitha të drejtave ligjore të garantuara me Ligjin mbi arsimin e lartë, në muajin shtator 2022 kemi vendosur ta mbyllim institucionin. Pas shtatorit 2022 nuk është zhvilluar asnjë aktivitet i procesit mësimor, nuk ka diplomuar askush dhe nuk është lëshuar asnjë diplomë.

Gjithashtu, ju informojmë se procesin e likuidimit të institucionit jemi duke e bërë duke u bazuar dhe respektuar të gjitha Ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, duke përfshirë Ligjin mbi Arsimin e Lartë, Ligjin e Arkivave të Kosovës dhe Ligjin për Administratën Tatimore të Kosovës dhe i tërë procesi i likuidimit pritet të mbyllet në vitin 2025.

Një situatë e tillë ka lënë të diplomuarit pa qasje në dokumentacionin e tyre zyrtar, specifikisht në librat amë të të diplomuarëve, që janë të domosdoshëm për vërtetimin dhe validimin e arritjeve të tyre akademike. Andaj, për të adresuar këtë problem dhe për të siguruar që të dhënat personale dhe akademike të të diplomuarve të Kolegjit Globus të jenë të ruajtura dhe të qasshme, ju konfirmojmë se jemi të gatshëm dhe kërkojmë dorëzimin e "Librave amë të të diplomuarëve" pranë Ministrisë së Arsimit për ruajtjen dhe administrimin e këtij dokumentacioni.

Kërkojmë të na udhëzoni se në cilin departament duhet t'i dorëzojmë "Librat amë të të diplomuarëve" pranë MASHTI-të dhe që ky proces të realizohet me prioritet e transparencë, sepse Neve jemi të obliguar ta bëjmë një njoftim të qartë publik për të gjithë të diplomuarit, në lidhje me vendin, mënyrën dhe procesin e validimit/vërtetimit të diplomave të tyre.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe përkushtimin tuaj në këtë çështje me rëndësi, që prek drejtpërdrejtë jetën akademike dhe profesionale të shumë individëve.

Me respekt,
Ahmet ARIF ecc. albi
Sekretar General



Prishtinë,
Dt. 17/12/2024